

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 1467 Rep.

Nr. 4211 Kol.



Tallos paguar

### KONTRATË SHITBLERJE KUOTASH

Kuota Kapitali Themelore

Në Tiranë, sot më datë 09.05.2007, u paraqiten personalisht para meje, notere Edlira Sako Hyseni, notere e dhomes se noterise Tirane, me adrese ne Bulevardin " Zog I", ne katin e dyte te pallatit 12 katesh, palet kontraktuese si vijon :

**SHITËSI :** Agim **HASANI**, i biri i Hasanit, lindur me 11 Mars 1954 ne Berat dhe banues ne Tirane, Rruga "Vaso Pasha" Pallati Nr.12, Shk.2, Ap.18, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes Nr. Z 2030138.

**BLERËSE :** Shoqëria tregtare "**NEPTUN**" sh.p.k. e regjistruar person juridik me vendimin Nr.26330 date 24.09.2001, me seli në Autostrada Tirane-Durres Km.6, me Nipti Nr. K 12222001 B përfaqësuar nga administratori Z.Julian **MANE**, biri Fatmirit, lindur më 15.01.1977 dhe banues në Tirane, Rruga "Deshmoret e 4 Shkurtit", mbajtës i pasaportës me Nr. Z 0899329, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**OBJEKTI I KONTRATES :** Shitblerja e kuotave ,bazuar në nenin 705 e vijues të Kodit Civil, neni 12-të i ligjit Nr. 7632, datë 4.11.1992 "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar", neni 47- të ligjit Nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Te dy palet me kerkuan redaktimin e kontrates qe vijon :

Shitësi Agim **HASANI**, në bazë të vendimit Nr.18719/8, datë 14.02.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, është Ortak me **75 %** (shtatëdhjetë e pesë përqind) i kuotave të Shoqërisë Tregtare "**ALCRED FOOD PROCESSING CO**" Sh.P.K.

Kapitali themelore i kësaj shoqërie është 56.798.519 lekë i nga te cilat :

I. Agim **HASANI** - **75 %** (Shtatëdhjetë e pesë përqind) të kuotave të kapitalit themeltar.

II. Aida **NANI** - **25 %** (Njëzet e pesë përqind) të kuotave të kapitalit themeltar.

Asambleja e Ortakëve të shoqërisë "**ALCRED FOOD PROCESSING CO**" Sh.P.K. me vendimin Nr. 29, datë 02.04.2007 ka vendosur :

Lejimin e transferimit (shitjes) së **100 %** (njëqind përqind për qind) të kuotave të kapitalit themeltarë të shoqërisë "**ALCRED FOOD PROCESSING CO**" Sh.P.K., shoqërisë "**NEPTUN**" sh.p.k. e përfaqësuar nga administratori Z. Julian **MANE**, e cila bëhet ortake e vetme e shoqërisë me **100 %** (njëqind përqind përqind).



Blerjen e 100% (njëqind për qind për qind) të kuotave të kapitalit themelitarë të shoqërisë "ALCRED FOOD PROCESSING CO" Sh.P.K.

Me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë palët lidhin kontratën e shitjes së kuotave të kapitalit themelore të shoqërisë tregtare "ALCRED FOOD PROCESSING CO" Sh.P.K. sipas kushteve dhe çmimit të fiksuar në aneks kontratën, e cila është pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë i kalojnë, ortakut të vetëm shoqërisë "NEPTUN" Sh.P.K., e cila detyrohet të paguaj kreditorët e shoqërisë "ALCRED FOOD PROCESSING CO" Sh.P.K. për detyrimet që kjo shoqëri ka karshi të tretëve, që janë tërësisht të dokumentuara me kontrata noteriale, fatura, mandate, invoice, për shumat e mbetur palikujduar sipas këtyre kontratave nga shoqëria dhe që rezultojnë të tillë sipas bilancit të miratuar të shoqërisë nga Dega e Tatim Taksave Tiranë deri në datën 30.04.2007 dhe në shumat e përcaktuara në këtë bilanc.

Detyrimet dhe shumat e tyre që do të paguhën nga "NEPTUN" sh.p.k. të tretëve janë të përcaktuar në listën e hartuar dhe nënshkruar më parë nga "ALCRED FOOD PROCESSING CO" sh.p.k. dhe "NEPTUN" dhe që i bashkagjitet kontratës dhe është pjesë e saj.

Me marreveshje të perbashkët të dy palet kanë përcaktuar se shuma për shitjen e 75% të kuotave të shoqërisë është 481.856 ( katerqind e tetedhjet e një mijë e teteqind e pesedhjet e gjashtë ) Euro, shume e cila do të likuidohet nga shoqëria blerese, sipas aneksit të kontratës bashkangjitur.

Shuma e të gjitha kredive të shoqërisë "ALCRED FOOD PROCESSING CO" Sh.P.K. që do të paguhën nga blerësja nuk do të jetë më e madhe se 2 287 251.83 Euro dhe të gjitha kreditë dhe detyrimet mbi këtë shumë do të paguhën nga shitësat.

Blerësja ka detyrimin të bëjë depozitim të akteve në Gjykatën e Rethit Gjyqësorë Tiranë në Zyrën e Tatimeve dhe në çdo organ që kërkohet.

### SHITËSAT

Agim HASANI

NOTER  
NOTERE  
EDLIRAS. HYSANI  
0692074797  
SOLEZIA@YAHOO.com

### PALËT

### BLERËSE

Shoqëria Tregtare "NEPTUN" Sh.P.K.  
Përfaqësuar nga Administratori

Julian MANE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 1468 Rep.

Nr. 41311 Kol.



Talera paguar

### KONTRATË SHITBLERJE KUOTASH

(Kuota Kapitali Themelore)

Sor ne daten 09.05. 2007 ( dymije e shtate) u paraqiten personalisht para meje, notere Edlira Sako HYSENI, me adrese ne Bulevardin " Zog I", ne katin e dyte te pallatit 12 katesh, palet kontraktuese si vijon :, bazuar në nenin 705 e vijues të Kodit Civil, neni 12-të i ligjit Nr. 7632, datë 4.11.1992 "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar", neni 47- të ligjit Nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", lidhet kontrata e shitjes kuotave të kapitalit themelore midis palëve ;

**SHITËSE :** Aida NANI, e bija e Sifit dhe e Vitorise, lindur më 27 Nentor 1973 ne Fier dhe banuese ne Tirane, Rruga " Komuna e Parisit" Kulla D Apartamenti 1,2 Selite Tirane, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajttese e pasaportes Nr. Z2033374

**BLERËS :** Shoqëria tregtare "NEPTUN" sh.p.k. e regjistruar person juridik me vendimin Nr.26330 date 24.09.2001, me seli në Autostrada Tirane-Durres Km.6, me Nipti Nr. K 12222001 B përfaqësuar nga administratori Z.Julian MANE, biri Fatmirit, lindur më 15.01.1977 dhe banues në Tirane, Rruga "Deshmoret e 4 Shkurtit", mbajtës i pasaportës me Nr. Z 0899329, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**OBJEKTI I KONTRATES :** Shitje e Kuotave te Shoqerise, bazuar në nenin 705 e vijues të Kodit Civil, neni 12-të i ligjit Nr. 7632, datë 4.11.1992 "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar", neni 47- të ligjit Nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", lidhet kontrata e shitjes kuotave të kapitalit themelore midis palëve ;

Shitësja Aida NANI, në bazë të vendimit Nr.18719/8, datë 14.02.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, është Ortak me 25 % (njëzet e pesë përqind) të Shoqërisë Tregtare "ALCRED FOOD PROCESSING CO" Sh.P.K.

Kapitali themelore i kësaj shoqërie është 56.798.519 lekë i cili zotërohet :

I. Agim HASANI - 75 % (Shtatëdhjetë e pesë përqind) të kuotave të kapitalit themeltar.

II. Aida NANI - 25 % (Njëzet e pesë përqind) të kuotave të kapitalit themeltar.

Asambleja e Ortakëve të shoqërisë "ALCRED FOOD PROCESSING CO" Sh.P.K. me vendimin Nr. 29, datë 02.04.2007 ka vendosur :

Lejimin e transferimit (shitjes) së 100 % (njëqind përqind për qind) të kuotave të kapitalit themeltarë të shoqërisë "ALCRED FOOD PROCESSING CO" Sh.P.K., shoqërisë "NEPTUN" sh.p.k. e përfaqësuar nga administratori Z. Julian MANE, e cila bëhet ortak e vetme e shoqërisë me 100 % (njëqind përqind përqind).

Me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë palët lidhin kontratën e shitjes së kuotave të kapitalit themelore të shoqërisë tregtare "ALCRED FOOD PROCESSING CO" Sh.P.K. sipas kushteve dhe çmimit të fiksuar në aneks kontratën, e cila është pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë i kalojnë, ortakut të vetëm shoqërisë "NEPTUN" Sh.P.K., e cila detyrohet të paguaj kreditorët e shoqërisë "ALCRED FOOD PROCESSING CO" Sh.P.K. për detyrimet që kjo shoqëri ka karshi të tretëve, që janë tërësisht të dokumentuara me kontrata noteriale, fatura, mandate, invoice për shumat e mbetur palikujduar sipas këtyre kontratave nga shoqëria dhe që rezultojnë të tillë sipas bilancit të miratuar të shoqërisë nga Dega e Tatim Taksave Tiranë deri në datën 30.04.2007 dhe në shumat e përcaktuara në këtë bilanc.

Detyrimet dhe shumat e tyre që do të paguhën nga "NEPTUN" sh.p.k. të tretëve janë të përcaktuar në listën e hartuar dhe nënshkruar më parë nga "ALCRED FOOD PROCESSING CO" sh.p.k. dhe "NEPTUN", e cila i bashkagjitet kontratës dhe është pjesë e saj.

Me marreveshje te dy palet kane percaktuar se çmimi i shitjes eshte 340.000 ( treqind e dyzetemije) Euro, shume e cila do te likuidohet sipas pershkrimit qe eshte bere ne aneksin e kesaj kontrate, e cila eshte pjese perberese e kontrates.


Shuma e të gjitha kredive të shoqërisë "ALCRED FOOD PROCESSING CO" Sh.P.K. që do të paguhën nga blerësja nuk do të jetë më e madhe se 2 287 251.83 Euro dhe të gjitha kreditë dhe detyrimet mbi këtë shumë do të paguhën nga shitësat.

Blerësja ka detyrimin të bëjë depozitimin e akteve në Gjykatën e Rethit Gjyqësorë Tiranë në Zyrën e Tatimeve dhe në çdo organ që kërkohet.

## P A L Ë T

### SHITËSE

Aida NANI



NOTERE

Edlira Sako HYSANI



### BLERËSE

Shoqëria Tregtare "NEPTUN" Sh.P.K.  
Përfaqësuar nga Administratori

Julian MANE

